

EPOKA E ARTË E ISLAMIT DHE PERËNDIMI

“Unë bëra atë që çdo njeri duhet të bëjë në punimin e tij: Vlerësova sukseset e paraardhësve, korrigojva pa u trembur gabimet e tyre dhe ua besova brezit të ardhshëm dhe njerëzve që do të vijnë më pas atë që duket si e vërtetë”.¹

Al Biruni (973-1048)

Orientalistët për Epokën e Artë të Islamit

Epërsia e qytetërimit modern perëndimor, e përthyer në një imperializëm ekonomik, politik dhe kulturor, është shumë e dukshme sot, në raport me pjesën tjetër të botës. Teoricienët e qytetërimeve dhe kulturave, duke filluar që nga Samuel Hantington, Francis Fukujama, Aleksandër Dugini etj., kanë paraqitur teza të argumentuara të cilat të çojnë në një përfundim:

“Historia ka treguar dhe tregon që qytetërimet jo vetëm janë në konkurrencë me njëra-tjetrën, por edhe mund të shkojnë në përplasje nga më ekstremet. Sipas Hantingtonit shumica dërrmuese e konflikteve në vijën e shkëputjes, megjithatë kanë ndodhur përgjatë kufirit që përshton Euroazinë dhe Afrikën, i cili ndan myslimanë dhe jomyslimanë. Ndërsa në makronivel ose në nivelin global të politikës botërore përplasja ndërmjet qytetërimeve ndodh ndërmjet Perëndimit dhe pjesës tjetër, në mikronivel ose në nivelin lokal ajo bëhet ndërmjet islamit e të tjerëve”.

Në 300 vitet e fundit, qytetërimi modern perëndimor ka qenë në pararojë të revolucionit teknologjik dhe shkencor, i cili ndryshoi në radhë të parë vetë Perëndimin dhe më pas me anë të këtij të fundit, tërë pjesën tjetër të botës. Ky qytetërim i solli botës edhe globalizmin, i cili synon që

1 Fuat Sezgin, “Epoka e madhe e panjohur”, Logos-A, Tiranë, 2015, f.19.

2 Samuel Huntington, “Përplasja e qytetërimeve”, Logos-A, Tiranë, 2009, f. 296.

të “gëlltisë” të gjitha kulturat e tjera, duke i bërë pasqyrë të Perëndimit. Pikërisht në këtë pikë fillon edhe polemika. A është logjike dhe e ndershme që të tëra vendet, kulturat, apo edhe fetë, të homogjenizohen duke u shndërruar në kopje karboni të Perëndimit? A është ky qytetërim, më i miri i shfaqur ndonjëherë? A fillon dhe mbaron historia me këtë qytetërim?

Në këtë shkrim do të përqendrohemi në marrëdhënien e Perëndimit me një qytetërim tjetër, i cili konsiderohet rival dhe në shumë aspekte i papërputhshëm me botën perëndimore, me islamit dhe botën që kjo fe krijoi. Ajo që vlen të përmendet dhe është e qartë, është se tashmë ekuilibrat janë përmbytur. Përgjatë periudhës mesjetare, Perëndimi, i përfaqësuar në atë kohë nga Europa e krishterë, ishte në pozita më të prapambetura se sa bota islame. Pikërisht periudha historike e shekujve VIII-XIII, jo vetëm që nuk njihet si periudhë zhvillimi e pacak e shkencës dhe e kulturës, por përkundrazi edhe sot e kësaj dite në të folurin e përditshëm Mesjeta, mbetet si simbol i errësirës që përfshiu botën. Në këtë mënyrë, qëllimisht apo naivisht, errësira mesjetare e cila ishte ëkarakteristikë e Europës, u bë dhe simbol i botës, duke lënë edhe sot e kësaj dite jashtë vëmendjes Epokën e Artë të Islamit.

“Ishte e pashembullt në historinë njerëzore. Arabia Veriore, Afrika e Veriut dhe Afrika Lindore nuk flisnin arabisht, por më vonë e bënë këtë. Kjo ishte gjurma e këtyre pionierëve në një kohë të errësirës, e cila krijoi themelet e forta të qytetërimit të ri, duke çuar në revolucionin protestant të Europës (Reformat), Rilindjen dhe Iluminizmin. Çrregullimet e qëllimshme të historisë kanë mbuluar kontributet e islamit dhe myslimanëve në qytetërimin njerëzor. Për fat të keq, vetë myslimanët kanë pak ose aspak ide për dritën e tyre shpirtërore, e cila tani ka humbur famën e saj. Rrjedhimisht, populli mysliman po jep pak ose aspak kontribut të rëndësishëm në fushën e shkencës moderne sot”,

-ka theksuar islamologu Abdulhamid Abusulayman.³

Sot, për nxënësin perëndimor, studimi i historisë së botës, asaj të letërsisë, artit dhe shkencave fillon me një përshkrim sipërfaqësor të Egjiptit të lashtë dhe Babilonisë, për t’u ndalur më pas gjerësisht te Greqia dhe Roma, e pas një kalimi të shkurtër mbi Bizantin, kapërcen te Mesjeta e krishterë, për të përfunduar më pas me historinë moderne. Europa

3 Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, “Kontributet myslimane në qytetërimin botëror”, *Milleniumi i Ri, Tiranë, 2019, f. 29.*

paramesjetare nuk përmendet thuajse fare, të paktën jo më shumë se ngjarjet jashtë-europiane të kohës së Mesjetës. Mbi këtë fakt orientalistja gjermane Sigrid Hunke do të shprehej:

“E kujt i intereson të dijë që në portat e vetë Europës, arabët kanë sjellë gjatë tre çerekë mijëvjeçari pishtarit e qytetërimin, që ata kanë njohur një periudhë qytetërimi dy herë më të gjatë se ajo e grekëve dhe që, në të vërtetë, e kanë ndikuar Perëndimin në mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më të ndryshme se këta të fundit? Këtij populli i jepet njëfarë rëndësie vetëm duke e krahasuar me grekët: janë pikërisht këta, që i kanë përcjellë Perëndimit thesaret e lashtësisë”.⁴

Pra, me pak fjalë, përmes studiuesve dhe shkencëtarëve të kombësive të ndryshme, ne kuptojmë se disa nga zbulimet më të rëndësishme dhe të njohura të njerëzimit, u bënë në Mesjetë, në një qytetërim që shtrihej nga Spanja deri në Kinë dhe që hodhi themelet e Rilindjes Europiane. Ky unitet pati sjellë një qytetërim të atillë, të cilit qytetërimi perëndimor i sotëm i detyrohet në shumë aspekte. Autori britanik, R.V.C. Bodley (1546-1613), e rrefen këtë të vërtetë në këtë mënyrë:

“I jemi borxhlinj islamit për Rilindjen. Një anëtar i një feje, e cila nxit për dituri duke vlerësuar meditimin dhe angazhimin për shkencë, si më të rëndësishme edhe se adhurimet vullnetare (nafilet); që vlerëson edhe gjumin e dijetarit/shkencëtarit dhe që vlerëson më shumë bojën e dijetarit, sesa gjakun e shehidit (dëshmorit), natyrisht do të interesohet për shkencë”.

Historiani dhe orientalisti Montgomeri Vat (1909-2006) shprehet:

“Në këtë kohë kur myslimanët bashkëjetonin me të krishterët dhe arabët me europianët, do të ishte shumë me vend bërja e një studimi lidhur me ndikimin e islamit në Europë. Panorama që kanë skicuar në mendje shkrimtarët e Mesjetës dihet tashmë që është tërësisht një produkt shpifës ndaj islamit. Tani, gjatë shekullit të kaluar, në saj të hulumtimeve të bëra nga studiuesit, kjo gjë po merr përmasa më të kthjellëta dhe objektive në syrin e perëndimorëve. Por syri i verbër i europianëve përbën pengesë për të vërejtur borxhin që i kanë kulturës islame. Nganjëherë e shpërfillim vlerën dhe fuqinë e ndikimit që i ka bërë islami trashëgimisë që na vjen nga e shkuara dhe nganjëherë bëjmë sikur nuk e shohim. Për të

*krijuar marrëdhënie më të mira me myslimanët dhe arabët, duhet të rrefejmë të gjitha borxhet që kemi. Mbajtja fshehtë dhe mohimi i tyre është tregues i një mendjelehtësie false”.*⁵

Sipas historianit të shkencës, George Sarton (1884-1956), çdo 50-vjeçar mes viteve (750 -1100), meriton të përmendet si epoka e atyre shkencëtarëve të mëdhenj myslimanë që kanë kontribuar për shkencë dhe kanë vënë emër me kontributin e tyre. Sipas tij, koha mes viteve 750 -800 duhet përmendur si “Epoka e Xhabirit”, vitet 800 -850 si “Epoka e Kuarizmit”, vitet 850 -900 si “Epoka e Razit”, vitet 900 -950 si “Epoka e Mesudit”, vitet 950 -1000 si “Epoka e Ebul-Vefasë”, vitet 1000 -1050 si “Epoka Birunit dhe Ibn Sinës”, vitet 1050 - 1100 si “Epoka e Ibn Al Hajthemit dhe Omer Kajamit” etj.⁶

Thuajse të gjithë i njohin emrat e Leonardo da Vinçit, Nikola Kopernikut, Galileo Galileit, Isak Njutonit apo deri edhe Albert Ajnshtajnit, por shumë pak kanë dëgjuar për Al Khindin, Abaz ibn Fernasin, Ebu Kasim al-Zahraëin dhe Al-Tusin. Më poshtë po rendisim disa nga shkencëtarët më në zë të Epokës së Artë Islame me kontributet e tyre. Duhet theksuar që për herë të parë dijetarët myslimanë hodhën themelet e shumë fushave të dijes, dhe për këtë arsye ata u quajtën “baballarë” të këtyre shkencave. Po përmendim disa prej tyre, si Al Kuarizmi (780-850) matematikan, babai i algjibrës, Al Khindi (801-873) fizikan, i cili ka hedhur përpara Albert Ajnshtajnit idenë se ligjet e natyrës janë relative, Ibn Fernasi (810-887) inxhinier, babai i aeronautikës, piloti i parë, Al Razi (854-925) mjek, babai i epidemiologjisë, Al Battani (858-929) astronomi më i madh i Mesjetës, Al Farabi (872-951) matematikan, filozof, muzikant që fliste në rreth 80 gjuhë, El Zaraui (939-1013) mjek, babai i kirurgjisë, Al Hejthem (965-1040) mjek, fizikan, babai i optikës, Al-Biruni (973-1050) babai i gjeodezisë, antropologu i parë, Al Idrizi (1100-1165) babai i gjeografisë, El Xhazeri (1136-1206) babai i inxhinierisë, Ibn Halduni (1332-1406), historian, sociolog, i konsideruar nga shumëkush si babai i shkencave shoqërore etj.

Dija islame, kontributi dhe tatëpjeta

Disa shpikje dhe zbulime të rëndësishme që Perëndimi do t`i sillte botës, lidhen me revolucionet industriale dhe teknologjike. Këtu përmendim:

5 https://www.progresibotime.com/post.php?p_id=1177.

6 Po aty.

makinën me avull, pompën me avull, meçikun vetëlëvizës, çelikut e thërrmuar, hekurin e galvanizuar, shufrën ndriçuese, makinën tjerrese të pambukut, makinën e parë me avull me qëllime prodhimi, veglat tjerrese hidraulike, gazin ndriçues, makinën për pastrimin e pambukut, plugun e hekurt etj.⁷ Më vonë, në shekujt XX dhe XXI, në Perëndim, do ta kishin origjinën edhe televizori, kompjuteri apo edhe interneti.

Po të ndiqnim të njëjtën logjikë dhe të bënim një udhëtim të ngjashëm përgjatë Epokës së Artë Islame, rezultatet do të ishin akoma edhe më të befashme. Kafeja, kamerat, fotoaparartet (kamera e parë optike, Ibn Al-Hejthem), fizika eksperimentale, shahu, sapuni, parfumi, ujitja, kollodoku, motori me djegie të brendshme, valvolat, pistonat, kombinimet e drynave, risitë arkitektonike, instrumentet kirurgjike, anestezia, helikopteri, trajtimi i lijës/inokulimi, stilografi, sistemi i numrave, algjebra/trigonometria, kriptologjia moderne, kristali i qelqit, tepihu, çequet etj., do të zbuloheshin nga shkencëtarët myslimanë. Gjithashtu, kopshtet e rregulluara për zbulurim dhe meditim, të përdorura deri atëherë vetëm për ilaçe dhe kuzhinë, universiteti, optika, notat muzikore, furça e dhëmbëve, spitalet, larja në banjë, jorgani, pijet e lehta, buzëkuqi, lapsi i syve, kirurgjia plastike, kaligrafia, e kishin origjinën dhe do të zhvilloheshin po në këtë qytetërim. Për të vazhduar pastaj me prodhimin e letrës në mënyrë masive, rrobave, parashutës etj. Ishte mysliman ai që ka zbuluar se drita futet përmes syrit dhe në bazë të kësaj është zbuluar kamera, ishte mysliman ai që ka provuar të fluturojë i pari në vitin 852. Ishte myslimani Xhabir Ibn Hajan i njohur si babai i kimitë moderne, i cili transformoi alkiminë në kimi. Ai zbuloi distilimin, purifikimin, oksidimin, avullimin dhe filtrimin. Ai po ashtu zbuloi acidin sulfurik dhe nitrik. Ishte myslimani El-Xhazeri ai që njihet si babai i robotikës. Ishte mysliman arkitekti i kështjellës së Henry V. Ishte mysliman ai që zbuloi gjilpërat për trajtimin e kataraktës së syve, teknikë e cila përdoret edhe sot e kësaj dite. Ishte mysliman ai që zbuloi se toka është e rrumbullakët, 500 vite para Galileut.

Një përsosje e madhe nga matematikanët myslimanë të sistemit indian ishte përcaktimi dhe zbatimi më i gjerë i zeros. Myslimanët i dhanë zero një vlerë tjetër në matematikë. Më parë zero përcaktonte një hapësirë ose një «asgjë». Ajo u përdor gjithashtu për dhjetësimin, duke bërë të mundur të dihet nëse, për shembull, shënimi i shifrës 23 nënkuptonte 230, 23 ose 2300.

Në shekullin IX, fermerët myslimanë realizuan risi të tilla si: futjen

7 Llabro Filo, Andi Pinari, "Historia e hershme moderne e Europës" (1500-1815), Ideart, Tiranë, 2007, f. 87-88.

e të lashtave të reja nga e gjithë bota, zhvillimin e sistemeve të ujitjes intensive, përdorimin e njohurive globale për kushtet lokale në një mënyrë shkencore, dhe promovimin e bujqësisë praktike që përfshinte pronësinë individuale të tokës. E gjithë kjo do të thoshte se ata mund të kishin një larmi ushqimesh të padisponueshme më parë.⁸

Përparimet e tyre inxhinierike ndodhën përgjithësisht për shkak të përparimit në matematikë, që do të thoshte se hidrologjia dhe makineritë për ndërtimin e pajisjeve të ujitjes po revolucionarizoheshin vazhdimisht. Matematikani dhe inxhinieri persian i shekullit XI Muhammad al-Karaji foli për «nxjerrjen në sipërfaqe të ujërave të fshehura». Ai gjithashtu studioi metodat e zbulimit të burimeve të ujit dhe udhëzimet për germimin e kanaleve nëntokësore. Këta kanale nëntokësore ose tunele u gërmuan për të parandaluar humbjen e ujit nga avullimi. Më të vjetrat ishin në Persi, dhe me zhvillimin e bujqësisë, dhe me mbjelljen e më shumë të lashtave, ato u bënë thelbësore veçanërisht në mjedisin e thatë të Lindjes së Mesme. Më vonë ata erdhën në Kordoba, Spanjë, duke e bërë ujin të disponueshëm për përdorim shtëpiak. Persia dhe Afganistani i sotëm kishin mijëra puse, të gjitha të lidhura me këto kanale nëntokësore.⁹

Ari dhe ari i bardhë, siç njihej kripa, udhëtuan nga Saharaja afrikane në Marok, Spanjë dhe Francë, me sasi më të vogla që hynë në Greqi, Turqi, Egjipt dhe Siri. Udhëtarët gjithashtu vërshuan së bashku me mallrat, siç eërdhën sheikët dhe sulltanët, njerëzit e mençur dhe pelegrinët. Tregtia e tokës që kalonte përgjatë Rrugës së Mëndafshit ishte zemra e ekonomisë myslimane. Tregtia detare ishte kryesisht përgjatë brigjeve mesdhetare të Afrikës dhe Europës. Porti i Malagës në Spanjën jugore ishte një qendër e trafikut të jashtëzakonshëm, e vizituar nga tregtarët nga të gjitha vendet, veçanërisht ata ëqë vinin nga republikat tregtare të Italisë, si Xhenova.¹⁰

Dar al-Islam, ose bota myslimane, përdornin monedha ari dhe argjendi si monedhë ndërkombëtare. Në shekullin e 14 -të, udhëtarët në botën myslimane mund të shisnin dhe të blinin në çdo cep të tregut dhe të përdornin dinarë ose dirhemë, që nga kryeqytetet deri në fshatin më të vogël. Të dyja monedhat, dinarët dhe dirhemët, u përdorën nga sundimtarë të ndryshëm myslimanë. Kalifi i parë që bëri monedhat e tij ishte Kalifi Omejad Abd al-Malik ibn Marwan, i cili sundoi nga viti 685 deri në vitin 705. Këta dinarë ishin monedhat e para të arta me një

8 Salim T.S. Al-Hassani, "1001 inventions: The Enduring Legacy of Muslim Civilization", National Geographic, Hong Kong, 2012, f. 12.

9 Po aty, f. 119.

10 Po aty, f. 141.

mbishkrim arab, pasi më parë paratë ishin monedha argjendi sasanide, dhe monedha bizantine ari dhe bakri. Duke bërë monedhat e tij në vitin 691 ose në vitin 692, Kalifi Abd al-Malik tani mund ta mbante sundimin e tij të pavarur nga Bizanti dhe të bashkonte të gjithë myslimanët me një monedhë.¹¹

Studentët myslimanë të mjekësisë ishin më të përgatitur se analogët e tyre në Europë. Qytetet myslimane kishin farmaci dhe spitale shumë cilësore, ku si mjekët ashtu dhe farmacistët duhet të merrnin provimet e shtetit në mënyrë që të pajiseshin me licenca përkatëse. Mjeku më i mirë mysliman ishte persiani El Razi, i cili shkroi më shumë se 100 punime mjekësore si dhe bëri edhe një përmbledhje të njohurive greke mbi mjekësinë, duke i shtuar edhe disa studime të tjera. Në shekullin XII- “Urdhri i mjekut”, hartuar nga Ibn Sina (*lat. Avicena*), u përkthye në latinisht dhe kërkohet shumë në Perëndim, saqë u botua 16 herë nga fundi i shekullit XV dhe më shumë se 20 herë në shekullin XVI.¹²

Vlen të përmendim se zbulimet të cilat u bënë përgjatë Epokës së Artë të Islamit, u arritën në kushtet e një kohe e cila ishte tepër e prapambetur në raport me zhvillimin teknik dhe teknologjik. Për këtë arsye këto zbulime dhe shpikje marrin përmasa edhe më të mëdha.

Gjithashtu, edhe në aspektin e demokracisë politike islami vuri një parim të ri i cili kishte kohë që ishte harruar jo vetëm nga europianët, por edhe nga formacione të tjera shtetërore të kohës si Perandoria Bizantine apo Perandoria Perse. Bëhet fjalë për zgjedhjen e lidërshiptit, në rastin konkret të kalifit (drejtuesit të shtetit islam), drejtpërdrejt nga populli. Në këtë mënyrë kundërshtohet çdo përpjekje për sundim dinastik apo mbretëror. Vlen të përmendet se kalifi i katërt i islamit, Aliu (601-661), ia la fronin gjatë përplasjes së madhe Muavijas, jo vetëm që të shmangte thellimin e luftës civile, por edhe duke i vënë kushtin që pasardhësi i kalifatit të zgjidhej nga populli dhe jo të emërohej nga sipër. Gjithashtu edhe Hyseini (626-680), djali i Aliut, shkoi në luftë duke dhënë jetën pikërisht kundër emërimit dinastik në drejtimin e shtetit. Pra, vihet re që praktikata e demokracisë liberale perëndimore kanë ekzistuar në gjirin e islamit shekuj më parë para se të lindnin dhe të përdoreshin si koncepte në Perëndim.

Arritjet ishin të mëdha edhe në fushën e shkencave shoqërore. Letërsia dhe filozofia islame sintetizoi arritjet më të mira të Aristotelit, tashmë të harruar në Perëndim, të neoplatonizmit, me kulturën përse dhe egjiptiane.

11 Po aty, f. 157-158.

12 Ermal Baze, “Shoqëria europiane në Mesjetë 500-1500”, Onufri, Tiranë, f.162.

Këto vepra të antikitetit grek dhe kulturave lindore, reflektojnë edhe në Europën mesjetare në përpjekjen e kësaj të fundit për t'u zhvilluar. Ibn Rushdi (1126-1198), (*latin.Averroes*) ishte një filozof, jurist, gjuhëtar dhe astronom i madh, i cili punoi në Andaluzinë spanjolle. Ai përktheu dhe komentoi Aristotelin, duke ia rikthyer në këtë mënyrë atë Europës. Në “Komedinë Hyjnore” të Dante Alighierit (1265-1321) vihet re fare qartë ndikimi i elementeve të historive islame sa i përket udhëtimit të Dantes për në botën e përtejme dhe ngritjen e tij deri te Zoti. Madje këtë fakt e pohon edhe vepra “Eskatologjia islame në Komedinë Hyjnore të Dante Alighierit” e shkruar nga Miguel Asin Palacios (1871-1944), prift katolik dhe njëkohësisht studiues i islamit.¹³

Sipas studiuesit Bernard Lewis, trashëgimia e Epokës së Artë Islame dhe sidomos ndikimi shkencor i saj në dijen e mëvonshme perëndimore është një nga trashëgimitë më të mrekullueshme nga të gjitha trashëgimitë e tij. Nga Andaluzia në Persi, nga moda te ushqimet dhe nga pasta e dhëmbëve tek arkitektura, algjebra, algoritmet, astronomia, mjekësia dhe pajisjet mekanike, pasuria e kësaj trashëgimie dhe studimi i saj kulturor është i befasishtëm. Sipas fjalëve të historianit Bernard Lewis, kalifati abasid dhe paraardhësit e tij, omejadët, ishin më të pasurit dhe më të ndryshmit nga të gjitha perandoritë paramoderne. Lewis vëren se para ngritjes së këtyre perandorive islame, pothuajse të gjitha qytetërimet në Kinë, Indi, Europë, Amerikë ishin të kufizuara në një rajon, një kulturë dhe zakonisht një racë. Sipas tij, kultura islame e Lindjes së Mesme ishte e para që ishte vërtet ndërkombëtare, ndërkulturore, ndër racore, në një kuptim, madje edhe ndërkontinentale dhe kontributi i saj i drejtpërdrejtë dhe i tërthortë në botën moderne është i madh.¹⁴

Pasi parashtruam çështjet e mësipërme, dikush me të drejtë mund të shprehë se bota islame dhe myslimanët sot, në raport me Perëndimin janë në një gjendje të prapambetur dhe se shkëlqimi i njëherë e një kohe ka rënë. Kjo është më se e vërtetë dhe i takon studiuesve të mprehtë e të zotë që të japin një shpjegim sa më të thelluar dhe objektiv për këtë çështje. Ajo që mund të theksojmë në këto pak rreshta është se pas rënies së Perandorisë Osmane, kësaj perandorie e cila megjithëse kishte ruajtur disa elemente të kalifatit (sistem shtetëror dhe qeverisës që ushtron ligjet e islamit dhe

13 Në mënyrë të veçantë, Asin Palacios krahason të dhënat e përdorura nga Dante Alighieri me literaturën fetare myslimane që hedh dritë mbi udhëtimin e profetit Muhamed gjatë Isras dhe Miraxhit dhe ndikimin që poeti florentin ka pasur prej poetit mysliman Ibn Arabi (1165-1240).

14 Eamonn Gearon, “*The History and Achievements of the Islamic Golden Age*”, Johns Hopkins University, USA, 2017, f. 197.

Kuranit), në shumë raste veproi në kundërshtim me islamin dhe Kuranin, Perëndimi copëtoi edhe kolonizoi një pjesë të madhe të botës islame. Pra, dobësia e njëtrës palë u shoqërua me fuqizimin e palës tjetër, e cila e përdori këtë fuqi duke kolonizuar madje tërë botën. Shumë studiues në zë, por edhe njerëz të thjeshtë, e identifikojnë prapambetjen e myslimanëve me fenë islame. Ajo që këta studiues dhe njerëz nuk kanë arritur të kuptojnë si duhet është se afro shtatë shekuj histori nuk të lejojnë as të keqinformohesh dhe as të gënjejesh. Gjeneratat e para të myslimanëve ishin gjithashtu edhe gjeneratat më të devotshme nga pikëpamja fetare. Si rezultat i kësaj devotshmërie arabët dhe popujt e tjerë përreth u shndërruan nga një grup fisesh beduine të përçara dhe të prapambetura që luftonin me njëri-tjetrin, në një superfuqi politike, shkencore dhe kulturore.

Sot, fatkeqësisht vendet islame janë vendet të cilat më së shumti janë në luftë. Këto vende kanë edhe numrin më të madh të emigrantëve që largohen. Sot, më shumë se kurrë vihet re një luftë e ashpër midis vetë myslimanëve dhe shumë fraksioneve të cilat luftojnë me njëri-tjetrin. Myslimanët sot akuzojnë edhe Perëndimin si shkaktar i gjendjes në të cilën ndodhet bota islame, duke e akuzuar si nxitës të përçarjes, financues të luftërave e kështu me radhë. Ajo që nuk mund të fshihet është se midis islamit dhe Perëndimit ka një hendek të madh sa i përket marrëdhënieve në çift dhe ekonomisë. Sa i përket të parës, islami dënon homoseksualizmin dhe në Kuran tregohet se si Zoti shkatërron një popull të tërë në hapësirën ku sot gjendet Deti i Vdekur. Perëndimi nga ana tjetër i konsideron këto fenomene si e drejtë natyrore dhe liri e individit, duke u shndërruar gjithmonë e më shumë në një Sodom gjigande.¹⁵

Për të krijuar një sistem ekonomik sa më të ndershëm dhe në mënyrë që pasuria të qarkullojë në mënyrë të drejtë, islami urdhëron që fajdeja me interes të ndalohet në mënyrë të prerë. Sërish e kundërta ka ndodhur në Perëndim. Ekonomia moderne, sistemi monetar ndërkombëtar që Perëndimi i solli botës pas Luftës së Dytë Botërore, u bazua në një sistem interesi që sot quhet kredi dhe në një sistem borxhi që sa vjen dhe thellohet.

Se ku do e çojë botën dhe njerëzimin kapitalizmi dhe demokracia liberale perëndimore, kjo mbetet për t'u parë, megjithëse njerëzit me intuitë dhe mprehtësi shpirtërore kanë filluar që të bëjnë parashikimet e tyre që tani.

15 Në Bibël tregohet historia e Sodomës dhe Gomorrës si dy qytete të cilat shkatërrohen si pasojë e dënimit të Zotit ndaj ushtrimit të homoseksualizmit në mesin e banorëve të këtyre qyteteve. Në Kuran ky popull njihet si populli i Lutit, duke e marrë emrin nga i Dërguari që Zoti dërgoi në mesin e këtij populli për t'u tërhequr vëmendjen.

Për përkrahësit e islamit, burimi kryesor i problemit është rënia shpirtërore dhe morale brenda shoqërive myslimane. Por edhe ky argument shtrun çështje të tjera të ndërlikuara. Çfarë është humbur nga ajo që islami ka dhënë? Më saktësisht cili element që përfaqëson shmangien nga islami është më përgjegjës për tatëpjetën që pasoi? Mungesa e një lidheshipi të drejtë dhe të mirë? Qeverisja e dobët? Venitja e shoqërive të drejta? Humbja e vlerave morale nga ana e masave të popullsisë? A ka të bëjë, thjesht, me mosrespektimin e Sharias (ligjit islam)? Apo, me një humbje të besimit (Imanit)?¹⁶ T`i japësh përgjigje pyetjeve të mësipërme nuk është e lehtë dhe do të kërkonte faqe të tëra me analiza. Një gjë është e sigurt sa i përket botës islame, ajo do të dalë padyshim nga gjendja në të cilën ndodhet, vetëm atëherë kur t`i kthehet porosisë së të Dërguarit, Muhamedit: “*Kush ndjek rrugën e dijes, Zoti do t`ia lehtësojë rrugën drejt parajsës*”.

Dilema mbetet e hapur, si për Perëndimin ashtu edhe për botën islame.

Bibliografia

1. Al-Hassani T.S. Salim, “*1001 inventions: The Enduring Legacy of Muslim Civilization*”, National Geographic, Hong Kong, 2012.
2. Baze Ermal, “*Shoqëria europiane në Mesjetë 500-1500*”, Onufri, Tiranë.
3. Filo Llambro, Pinari Andi, “*Historia e hershme moderne e Europës (1500-1815)*, Ideart, Tiranë, 2007.
4. Fuller E. Graham, “*Islami politik e ardhmja e tij*”, Arbëria, 2010.
5. Gearon Eamonn, “*The History and Achievements of the Islamic Golden Age*”, Johns Hopkins University, USA, 2017.
6. Hunke Sigrid, “*Dielli i Allahut shkëlqen mbi Perëndimin*”, Tiranë, 2007.
7. Huntington Samuel, “*Përplasja e qytetërimeve*”, Logos-A, Tiranë, 2009.
8. Instituti Shqiptar i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, “*Kontributet myslimane në qytetërimin botëror*”, Milleniumi i Ri, Tiranë, 2019.
9. Palacios Asin Miguel, “*Eskatologjia myslimane në Komedinë Hyjnore*”, Averroes, 2003.
10. Sezgin Fuat, “*Epoka e madhe e panjohur*”, Logos-A, Tiranë, 2015.
11. Interneti: <https://www.progresibotime.com>

16 Graham E. Fuller, “*Islami politik e ardhmja e tij*”, Arbëria, 2010, f. 38.